

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës në pozicionin e Laborantit pranë Departamentit të Urbanistikës:

A. Kandidatët për personel ndihmësakademik në pozicionin e “Laborantit” pranë Departamentit të Urbanistikës në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” ose studimet e integruara në një program studimi të njëjtë me ato që ofrohen nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës apo në një nga programet e studimit që ofrohen nga Universiteti Politeknik i Tiranës;
2. Kandidatët duhet të kenë notë mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta së paku 70/100. Preferohen kandidatët të cilët kanë kryer studimet në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës;
3. Kandidatët duhet të kenë eksperiencë së paku 3 (tre) vite punë. Preferohen kandidatët të cilët kanë eksperiencë në pozicione administrative pranë institucioneve të ndryshme;
4. Të zotërojnë të paktën një gjuhë të huaj të mbrojtur dhe vërtetuar me dëshminë/certifikatën përkatëse. Preferohet anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht ose spanjisht;
5. Preferohet që kandidatët të kenë kryer kurse dhe kualifikime të mëtejshme, të cilat ndihmojnë në kontributin e tyre si laborant pranë departamentit.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **01.06.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.